

Instituti GAP

## Letërnjoftimi i Komunës së Junikut 2013

Maj, 2013

*“Letërnjoftimi i Komunave”* është projekt i Institutit GAP i cili vlerëson qeverisjen komunale tri vite pas zgjedhjeve lokale të 2009. Ky projekt është implementuar në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe Qendrën e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Rezultatet e hulumtimeve të GAP për qeverisjen komunale janë debatuar me kryetarët e komunave në emisionet “Jeta në Kosovë”.

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive .....	3
1. Hyrje .....	4
2. Performanca buxhetore e Komunës së Junikut.....	5
3. Investimet kapitale .....	7
4. Administrata komunale dhe sistemi i arsimit në Komunën e Junikut .....	8
5. Transparenca në Komunën e Junikut.....	10
6. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009 .....	12
7. Burimet .....	14

## Përmbledhje ekzekutive

Komuna e Junikut e themeluar fillimisht si pilot njësi komunale është transferuar në komunë me kompetenca të plota nga janari i vitit 2010. E shtrirë në rrafshin e Dukagjinit, me një popullsi mbi 6 mijë banorë, Juniku vlerësohet të ketë potenciale të mira për zhvillimin e turizmit, ekonomisë rurale dhe sidomos për promovimin e trashëgimisë kulturore.

Nga zgjedhjet lokale të vitit 2009 për kryetar të komunës, junikasit kanë zgjedhur Agron Kuçin, i cili ka përfaqësuar partinë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Niveli i investimeve kapitale në Komunën e Junikut është thellësisht i varur nga ndihma financiare e Qeverisë së Kosovës dhe donatorëve ndërkombëtar. Shkalla e të hyrave vjetore në këtë komunë nuk kalon 80.000 euro, shumë kjo e pamjaftueshme për të realizuar projekte dhe investime të mëdha.

Juniku nuk ka arritur aq mirë të ndërlihd investimet kapitale me nevojat më urgjente komunale. Kështu për shembull, kjo komunë gjatë tri viteve të fundit nuk ka arritur të ndërtojë një çerdhe publike, përderisa ka investuar rreth 50.000 euro në forcimin e rrjetit elektrik dhe zhvendosjen e tij, punë kjo që do të duhej të mbulohej nga ana e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK).

Udhëheqësit e Junikut, ndonëse kanë treguar vullnet për t'i adresuar dhe zgjidhur problemet infrastrukturore, vullnet i njëjtë nuk është hasur edhe për të promovuar një qeverisje transparente dhe llogaridhënëse. Kjo komunë hyn në mesin e komunave me nivelin më të ulët të transparencës. Ky institucion përveç që nuk ka zyre dhe zyrtar përgjegjës për informim, informatat që postohen në ueb faqen zyrtare janë të pakta, të rralla dhe sipërfaqësore. Zyrtarët e kësaj komune kanë shpërfillur dhe nuk janë përgjigjur në kërkesa për qasje në dokumentet publike, ndonëse kjo sanksionohet dhe rregullohet me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Gjatë viteve 2010-2011, kjo komunë ka shpenzuar 17.722 euro për dreka dhe darka, mbi 22.000 euro për derivate për vetura, afro 15.000 euro janë shpenzuar për telefoni mobile dhe fikse dhe afro 12.000 euro në udhëtime e mëditje jashtë vendit.

Komuna e Junikut ka përjashtuar pesë mësimdhënës nga puna nga gjimnazi "Kuvendi i Junikut" me arsyetimin se ata nuk janë të komunës së Junikut. Pas kësaj, këta mësimdhënës janë ankuar në MASHT si dhe në gjykatën komunale në Pejë dhe të dy këto instanca kanë nxjerrë vendim për kthimin e tyre në vendet e punës, por vendimi ende nuk është respektuar nga ana e Komunës së Junikut.

Në këtë raport pasqyrohen zhvillimet rreth politikave publike në Komunën e Junikut për periudhën janar 2010 – dhjetor 2012. Instituti GAP ka analizuar shpenzimet buxhetore të kësaj komune, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet komunale, ka analizuar trendin e investimeve kapitale si dhe është dhënë vlerësim i përgjithshëm në lidhje me funksionimin e administratës komunale si dhe shkallën e transparencës së organeve komunale ndaj qytetarëve dhe opinionit të gjerë.

# 1. Hyrje

Juniku është formuar si komunë nga procesi i decentralizimit, i nisur në fillim të vitit 2007. Në atë kohë Juniku, Mamusha, Graçanica, Kllokoti, Parteshi dhe Hani i Elezit kanë fituar epitetin e pilot njësisë komunale për t'u shndërruar në komuna të plotfuqishme nga janari i 2010, përkatësisht pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale.<sup>1</sup>

Në Komunën e Junikut jetojnë 6.084 banorë.<sup>2</sup> Kjo komunë shtrihet në veriperëndim të Kosovës dhe mbulon një sipërfaqe prej rreth 74 km<sup>2</sup>. Shifra e regjistrimit të popullsisë nuk ka përkuar me supozimet e mëhershme për numrin e banorëve në Junik. Granti për Komunën e Junikut nga ana e Qeverisë së Kosovës i është ndarë për 9.600 banorë, apo rreth 3.600 me shumë se numri i dal nga regjistrimi i popullsisë.<sup>3</sup> Më herët, Juniku ka qenë pjesë territoriale dhe administrative e Deçanit dhe Gjakovës.

Juniku bashkë qeveriset nga AAK dhe PDK. Kryetar i kësaj komune, në zgjedhjet e nëntorit të vitit 2009, është zgjedhur Agron Kuçi nga AAK. Menjëherë pas zgjedhjeve është lidhur koalicioni me PDK, i cili ka rezultuar me emërimin e nënkryetarit të Komunës Nimon Tofaj (njëkohësisht daja i Agron Kuçit). PDK ka marrë pozitën e nënkryetarit të komunës, ndonëse në Kuvendin Komunal përfaqësohet me vetëm një përfaqësues. Zgjedhja e z.Kuçi kryetar komune ka ardhur pas balotazhit. Në rrethin e parë të zgjedhjeve kandidat për kryetar ka qenë edhe nënkryetar aktual i Komunës, Nimon Tofaj, i cili nuk ka arritur të hyjë në rrethin e dytë të zgjedhjeve. Në rrethin e dytë kanë hyrë Agron Kuçi (AAK) dhe Tahir Isufaj (LDK). Ky i fundit në balotazh ka fituar 43.3% të votave, kundrejt Kuçit i cili ka marrë 56.7%.

Kryetari Kuçi para marrjes së pozitës së Kryetarit të Komunës ka vepruar si avokat dhe ish Drejtor i Qendrës për Punë Sociale në Deçan (2004-2008). Komuna e Junikut ka gjithsej gjashtë drejtori: Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Planifikim, Urbanizim, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Inspektion.

Kuvendi i Komunës së Junikut përbëhet prej 15 asambleistëve, shtatë prej tyre janë nga AAK, pesë përfaqësues janë nga LDK, dy përfaqësues nga LDD dhe një përfaqësues është i PDK.<sup>4</sup>

---

<sup>1</sup>Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Raport vlerësimi. Nga pilot njësi komunale në komuna më të drejta të plota. Fq 4-5. Burim: <http://www.osce.org/sq/kosovo/67466>

<sup>2</sup>Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Komuna e Junikut. Burimi: [http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)

<sup>3</sup>Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Fq 22. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)

<sup>4</sup>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Fq 33. Komuna e Junikut. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/sq/rezultatet-2009/Index>

## 2. Performanca buxhetore e Komunës së Junikut

Gjatë viteve 2010-2012, Komuna e Junikut ka shpenzuar buxhet në vlerë prej mbi 3.7 milionë euro. Llogaritur edhe me shumën e mjeteve që kjo komunë ka në dispozicion, gjatë 2013 rezulton se Juniku gjatë këtij mandati katër vjeçar (2010-2013) do të shpenzojë mbi 5.1 milionë euro. Shuma më e madhe e këtyre mjeteve janë dedikuar për paga, pastaj për investime kapitale, mallra dhe shërbime dhe në linjat tjera të buxhetit, si për subvencione dhe shpenzime komunale.

Tabela nr.1: Orientimi i mjeteve financiare nga Komuna e Junikut gjatë katër viteve (2010-2013) llogaritur në total

Kategoritë	Shuma (euro)
Për investimet kapitale	1.123.509
Për paga	3.090.773
Për subvencione	60.125
Për shpenzime komunale	138.234
Për mallra dhe shërbime	689.553
<b>Gjithsej</b>	<b>5.102.194</b>

Tabela nr.2: Buxheti i përgjithshëm i Komunës së Junikut sipas viteve (2010-2013)

Kategoria	2013	2012	2011	2010
Investime Kapitale	267.680	254.472	338.917	262.440
Mallra dhe shërbime	146.368	272.059	137.208	133.918
Subvencion dhe transfere	7.000	5.000	44.125	4.000
Shpenzime komunale	35.061	36.079	33.721	33.373
Paga	865.564	830.962	784.991	609.256
<b>Gjithsej</b>	<b>1.321.673</b>	<b>1.398.572</b>	<b>1.338.962</b>	<b>1.042.987</b>

Mbi 95% e buxhetit për Komunën e Junikut sigurohet nga granti qeveritar, përkatësisht nga mjetet që ndan niveli qendror si grant specifik për komuna që është i bazuar në numrin e popullsisë dhe në gjerësinë territoriale të komunës. Brenda grantit nga niveli qendror hyn edhe granti specifik për arsim, ai për shëndetësi si dhe qarkorja e programuar për paga. Niveli i të hyrave komunale nga Juniku është tejet simbolik, përkatësisht gjatë një viti kjo komunë mbledh rreth 80.000 euro të hyra vetanake. Për dallim nga komunat e tjera të krijuara së fundmi (për shembull Komuna e Mamushës), në Komunën e Junikut haset një konsolidim më i plotë i mekanizmave të komunës në vjeljen e të hyrave. Gjatë katër viteve të fundit niveli i përgjithshëm i të hyrave në Komunën e Junikut ka shënuar rritje graduale.

Tabela nr.3: Pasqyrimi i të hyrave komunale në dy vitet e fundit sipas sektorëve në Komunën e Junikut

Linja e të hyrave	Shuma (euro)	
	2011	2012
Të hyra nga administrata	5.064	6.256
Të hyra nga urbanizimi	6.595	6.407
Të hyra nga sektori i shëndetësisë	6.308	6.021
Të hyra nga gjobat policore ne trafik dhe gjykata	1.980	2.254
Të hyra nga tatimi në pronë	31.250	29.055
Të hyra nga lejet për biznes dhe veprimtaria	3.980	4.715
Të hyra nga regjistrimi i veturave	6.021	6.308
Të hyra të tjera (Inspekcioni, arsimi, kadastër)	14.617	18.137
<b>Gjithsej</b>	<b>75.815</b>	<b>79.153</b>

Në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve janë hasur shpenzime me shifra relativisht të larta, kur kihet parasysh madhësia territoriale dhe administrative e kësaj komune. Komuna e Junikut nuk ka pranuar t'i bëjë publik asnjërin nga raportet financiare të këtij institucioni që lidhen me shpenzimet e parasë publike. Raportet financiare nuk publikohen për publikun as në ueb faqen zyrtare të këtij institucioni dhe njëherazi zyrtarët e kësaj komune nuk i janë përgjigjur disa kërkesave radhazi për qasje në dokumentet publike. Sigurimi i të dhënave në tabelën e më poshtme është bërë duke i shfrytëzuar raportet financiare të Komunës së Junikut të cilat Auditori i Përgjithshëm (ZAP) i ka të bashkangjitura në raportet e Auditimit.<sup>5</sup>

Tabela nr.4: Pasqyrimi i shpenzimeve të buxhetit në disa kategori nga Komuna e Junikut në linjën e mallrave dhe shërbimeve për vitin 2010 dhe 2011

Kategoritë	2010	2011	Totali
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	6.900	4.850	11.750
Shpenzime ne telefonin mobile	4.812	6.920	11.732
Shpenzimet ne telefonin fikse	00	3.670	3.670
Shpenzime për furnizim për zyre	13.550	11.900	25.450
Naftë për ngrohje	4.680	1.960	6.640
Derivate për gjenerator	1.580	6.780	8.360
Derivate për vetura	9.901	12.120	22.021
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	4.697	8.850	13.547
Reklama dhe konkurse	6.730	980	7.710
Dreka dhe darka zyrtare	7.822	9.900	17.722
Mirëmbajtja e rrugëve lokale	935	1.980	2.915

<sup>5</sup>Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2011. Pjesa e dytë. Raporti Financiar i Komunës së Junikut . Fq 28. Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Junik\\_2011\\_ALB\\_402805.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Junik_2011_ALB_402805.pdf)&[http://www.oag-rks.org/repository/docs/Junik\\_alb\\_666846.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Junik_alb_666846.pdf)

Gjatë viteve 2010-2012, tenderët për furnizimin e komunës me material administrativ-shpenzues (letër dhe ngjyrë), Komuna e Junikut ia ka dhënë firmës nga Deçani “Agimi de” e cila është firmë e vëllait të Kryetarit të Komunës së Deçanit Rasim Selmanaj. Kontrata e parë më 2010 është dhënë në vlerë prej 9.642 euro,<sup>6</sup> kurse kontrata e dytë ka qenë në vlerë prej 9.987 euro.<sup>7</sup> E njëjta kompani për të njëjtën qëllim ka marrë tender në Junik gjatë vitit të fundit(2012) në vlerë prej 9.754 eurove.<sup>8</sup>

Ekzekutivi i komunës së Junikut u ka dërguar këshilltarëve të Kuvendit Komunal raportin financiar për vitin 2011, por raporti iu është dërguar vetëm në pika të përgjithshme, pa u specifikuar shpenzimet e detajuara. Për më tepër, ky raport atyre iu është shpërndarë vetëm në mënyrë të printuar , jo edhe përmes postës elektronike. Anëtarët e Kuvendit Komunal janë ankuar se raporti i cili u është shpërndarë ka qenë i palexueshëm, për shkak të printimit të dobët. Asnjëri nga këshilltaret nuk e ka të qartë se sa shpenzon Kryetari i Komunës për udhëtime, mëditje, dreka, karburant, telefon e kështu më radhë. Ekzekutivi dërgon në Kuvend vetëm shifrat përmbledhëse dhe të përgjithshme.<sup>9</sup>

Pozitën e nënkryetarit të Komunës e mban Nimon Tofaj i PDK i cili është daja i kryetarit të Komunës Agron Kuçi. Familjarët e nënkryetari (djemtë e tij), udhëheqin me kompaninë private “VB Tofaj” e cila kompani rezulton se gjatë tri viteve të fundit kanë fituar katër tenderë në Komunën e Junikut për rregullimin e infrastrukturës.<sup>10</sup>

### 3. Investimet kapitale

Mundësitë buxhetore të Komunës së Junikut mbeten tejet të vogla për të realizuar investime të gjëra në fushën e investimeve kapitale. Gjatë një viti, kjo komunë ka në dispozicion rreth 270.000 euro për të investuar. Pjesa më e madhe e investimeve të hasura në Komunën e Junikut gjatë tri viteve të fundit ka ardhur nga donacionet, përkatësisht nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Ministria e

---

<sup>6</sup>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura.2010. Komuna e Junikut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=28096>

<sup>7</sup>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura.2011. Komuna e Junikut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=46293>

<sup>8</sup>Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura.2012. Komuna e Junikut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=60693>

<sup>9</sup>Hulumtuesit e Institutit GAP. Vizitë në terren. Përfaqësuesi i LDK-së në Kuvendin Komunal Ali Kuçi. Korospodenti “Koha Ditore” NaimHaxhosaj. Përfaqësuesit e GAP-it kanë parë versionin original të raportit financiar që i është dërguar këshilltareve të Kuvendit Komunal të Junikut nga ana e ekzekutivit në 2011.

<sup>10</sup>Gazeta “JetanëKosovë”.Shkruar: ArmendZemajdheNaimHaxhosaj. 20 maj 2013.Burimi:<http://gazetajnk.com/?cid=1,987,5601>

Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor si dhe nga ana e donatorëve ndërkombëtar, si Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.

Tabela nr. 5: Pasqyrimi i disa nga investimet kapitale të Komunës së Junikut gjatë vitit 2010, 2011 dhe 2012

Projektet kryesore të realizuara	Shuma (euro)
Zhvillimi i parkut natyral "Moronica"	41.534
Renovimi dhe izolimi i dhomës radiologjike ne QKMF	8.430
Rregullimi i disa pjesëve në shkollën "Edmond Hoxha"	3.109
Rregullimi i kanalit në lagjen Miroc	6.500
Rregullimi i rrugës "Berisha"	10.340
Rehabilitimi i rrjetit elektrik në lagjen "Berisha"	9.996
Renovimi i kulmit të objektit të komunës	9.997
Rregullimi i shtratit të lumit Erenik dhe Junik 'Faza 4'	31.789
Konservimi i kullës se Hoxhajve	9.945
Rregullimi i shtratit të lumit Erenik 'Faza e tret'	83.620
Rikonstruimi i rrugës në relacionin Junik - Voksh	244.738
Rregullimi i rrugës në lagjen "Bajraktari"	146.336
Rehabilitimi i rrjetit elektrik në lagjen Gacaferri	9.997
Rikonstruimi i rrugës në lagjen Pepsh	146.611
Rregullimi i oborrit të komunës	30.000
Rikonstruimi i rrugës në relacionin Junik - Gjakovë	6.220
Rregullimi i shtratit të lumit Erenik 'Faza e dytë'	141.654
Rregullimi i shtratit të lumit Erenik 'Faza e parë'	443.089
Rikonstruimi i rrugës në lagjen Gaxherri	18.571
Rregullimi i rrjedhjes së ujitjes në zonën Gogaj	6.218
Ndërtimi i rrugës ne relacionin shkollë - mulli i vjetër	38.923
Ndërtimi i rrjetit elektrik në lagjen Çokë	9.226

#### 4. Administrata komunale dhe sistemi i arsimit në Komunën e Junikut

Komuna e Junikut numëron gjithsej 167 persona të punësuar në administratë, arsim dhe shëndetësi.

Tabela nr.6: Numri i të punësuarave sipas drejtorive dhe sektorëve në Komunën e Junikut

Drejtorit/Sektorët	Numri i të punësuarave
Zyra e Kryetarit	8



Drejtoria e Administratës	13
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	8
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë	6
Drejtoria e shërbimeve publike	10
Drejtoria e Shëndetësisë	3
Drejtoria e Urbanizimit	4
Zyra për Komunitete	1
Të punësuarit në sistemin arsimor	85
Qendra e Mjekësisë Familjare	24
<b>Gjithsej</b>	<b>167</b>

Administrata e Komunës së Junikut në disa raste ka shpërfillur rregullat ligjore për ditët e pushimit duke ndërmarrë njëanshëm vendime për zgjatjen e ditëve të pushimeve duke i lidhur festat me ditët e vikendit. Kjo praktikë është konsideruar e jashtëligjshme nga ana e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.<sup>11</sup>

Komuna e Junikut nuk ka asnjë çerdhe publike dhe nuk ka planifikuar ndërtimin e ndonjë çerdheje, ndonëse nevojat në këtë drejtim në atë lokalitet mbeten të theksuara. Juniku ka dy shkolla fillore dhe një shkollë të mesme.

Tabela nr.7: Numri i mësimitdhënësve dhe stafit përcjellës në dy shkollat fillore dhe në shkollë të mesme të Junikut:

Gjinia	Shkolla fillore		Shkolla e mesme	
	Mësimitdhënës	Stafi ndihmës	Mësimitdhënës	Stafi ndihmës
Femra	27	0	7	0
Meshkuj	25	12	10	4
<b>Gjithsej</b>	<b>52</b>	<b>12</b>	<b>17</b>	<b>4</b>

Tabela nr.8: Numri total i mësimitdhënësve, nxënësve dhe stafit ndihmës në dy shkolla fillore dhe në shkollë të mesme në Komunën e Junikut

Kategoria	Numri	F	M
Mësimitdhënës	69	34	35
Nxënës	1.206	588	618
Stafi ndihmës	16	0	16

Komuna e Junikut ka përjashtuar nga puna pesë mësimitdhënës nga gjimnazi “Kuvendi i Junikut” me arsyetimin se ata nuk janë të komunës së Junikut. Pas kësaj këta

<sup>11</sup>Gazeta “Jeta në Kosovë”. 10 maj 2013. Naim Haxhosaj. Komuna e Junikut i cakton festat vetë. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,1018,5523>

mësimdhënës janë ankuar në MASHT si dhe në Gjykatën Komunale në Pejë dhe të dy këto instanca kanë nxjerrë vendim për kthimin e tyre në vendet e punës, por vendimi ende nuk është respektuar nga ana e Komunës së Junikut.<sup>12</sup>

## 5. Transparenca në Komunën e Junikut

Komuna e Junikut, krahas Komunës së Mamushës, janë komuna të cilat nuk kanë të themeluar Zyre për Informim apo për marrëdhënie me publikun. Asnjë zyrtar nuk është përgjegjës për dhënien e informatave nga kjo komunë. Asistentja e Kryetarit, kohë pas kohe, ngarkohet edhe me përgjegjësinë e komunikimit me palët e jashtme duke përfshirë mediat dhe përfaqësuesit e organizatave nga shoqëria civile. Kjo ka ndikuar që Komuna e Junikut të ketë nivel të ulët të transparencës. Kësaj i kontribuon edhe mungesa e pranisë së përhershme të medieve dhe OJQ-ve lokale. Pavarësisht kësaj, Komuna ka mundur që t’u ofrojë qytetarëve qasje në informata përmes ueb faqes zyrtare, mekanizëm ky që pothuajse nuk është shfrytëzuar fare nga qeveria komunale. Ueb faqja e komunës nuk freskohet me të dhëna, ndërkohë që mungojnë edhe të dhënat themelore mbi funksionimin e komunës dhe vendimmarrjen.

Kjo komunë ka refuzuar t’i bëjë publike raportet dhe të dhënat financiare edhe përkundër që Instituti GAP gjatë vitit 2012 dhe 2013 ka dërguar disa herë radhazi kërkesa në përputhje me Ligjin për Qasje ne Dokumentet Publike.

Tabela nr. 9: Vlerësim i përmbajtjes së ueb faqes së Komunës së Junikut

<https://kk.rks-gov.net/junik/Home.aspx>

Dokumenti	2010				2011				2012			
	I	II	III	IV	I	II	III	IV	I	II	III	IV
Raporti i Punës së Kryetarit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raporti financiar (buxhetor) i Komunës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet e Drejtorisë së Administratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtorja e Shëndetësisë	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x

<sup>12</sup>Gazeta “Jeta në Kosovë”. 30 janar 2012. Edona Musa. Komuna nuk respekton vendimet e gjykatës. Burimi: <http://gazetajnk.com/?cid=1,979,1238>

Drejtoria për Buxhet dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Arsimit dhe Kulturë	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Shërbimeve Publike	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Drejtoria e Urbanizimit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Raportet dhe njoftimet e Zyrës së Prokurimit	x												
Raportet e Njësisë së Auditimit të Brendshëm	x												
Procesverbalet e Kuvendit Komunal	x			x			x						
Rregulloret Komunale	√												
Vendimet e Kuvendit Komunal	√			√			√						
Rregullorja e Punës së Kuvendit Komunal	√												
Procesverbalet e Komitetit për Politikë dhe Financa	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x	x
Planet dhe Strategjitë e Komunës	x												

X = mungon raporti.

√ = raporti është i publikuar në ueb-faqe.

## 6. Përmbushja e premtimeve të fushatës zgjedhore 2009

Gjatë fushatës zgjedhore 2009 kandidati për kryetar komune, tani Kryetari i Komunës z.Agron Kuçi, para elektoratit të tij ka shpalosur premtime në sfera të ndryshme. Pas monitorimit të të gjitha premtimeve të dala nga fushata zgjedhore, Instituti GAP dhe BIRN, në majtë 2010 i kanë shkruar letër të hapur Kryetarit të Komunës të cilit iu përkujtuan edhe një herë premtimet e dhëna, duke kërkuar njëkohësisht realizimin e tyre.

Tabela e mëposhtme vlerëson progresin e arritur në realizimin e premtimeve të dhëna në vitin 2009. Në këtë tabelë janë përfshirë 11 premtime të dhëna. Në bazë të hulumtimit të GAP del se pas tri viteve të qeverisjes në Komunën e Junikut, 3 premtime janë përmbushur, 3 tjera nuk janë përmbushur, ndërsa në 5 premtime ka pasur nisma dhe rezultate evidente, por nuk mund të konsiderohen akoma premtime të përmbushura.

Premtimet e 2009	Realizimi 2010-2013
Asfaltimin e të gjitha rrugëve lokale	Premtim pjesërisht i përmbushur. Që nga fillimi i mandatit të kryetarit aktual të Junikut, të asfaltuara rezultojnë rreth 4 km rrugë, ndërsa llogaritet që rreth 3.5 km janë akoma të patrajtuara dhe të paasfaltuara. Kësisoj, llogaritet e ristrukturuar rruga në lagjen "Bajraktari", në lagjen "Pepsh", po ashtu segmenti Junik-Nivokaz. Asfaltimi është finalizuar edhe në rrugën e lagjes "Berisha", në rrugën "Çok" si dhe në rrugën e "Gacaferrve".
Furnizimin me ujë të pijshëm për 24 orë në ditë.	Furnizimi me ujë të pijes në Junik është zgjidhur në vitin 1996 kur nga diaspora janë sjellë mbi 500 mijë marka gjermane me të cilat është rregulluar/zgjidhur çështja e ujit të pijes. Pa e zgjidhur këtë problem kanë qene dy lagje të krijuara pas vitit 1999.
Ndërtimin e qendrës kulturore.	Nuk ka nisur ndërtimi i asnjë qendre kulturore. Komuna ka shpallur një shtëpi/kullë si qendër kulturore, por kjo më shumë ka karakter të shpalosjes se trashëgimisë dhe lashtësisë se sa të shtëpisë së kulturës ku do të mund të organizoheshin shfaqje dhe aktivitete tjera kulturore. Premtim i pa përmbushur.
Lidhjen e lagjes "Gocaj" në ujësjellës dhe riparimin e rrjetit	Premtim i përmbushur.

kryesor në lagjen "Gacaferi" .	
Ndërtimin e fushës së futbollit.	Premtim pjesërisht i përmbushur. Një fushë është ndërtuar në oborrin e shkollës së gjimnazit "Kuvendi i Junikut" por standardet e saj ofrojnë hapësirë për nxënësit, por jo edhe për të rinjtë.
Ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza.	Premtim pjesërisht i përmbushur. Në lagjen "Krasniqi" është rregulluar kanalizimi i ujërave të zeza si dhe në lagjen "Hykasmuj", por jo edhe në pjesët tjera.
Themelimin e ndërmarrjes publike për pastrimin e mbeturinave.	Nuk është realizuar. Vendimi është nxjerr nga viti 2010, ka mbetur i pa zbatuar edhe për faktin se Komunitat nuk kanë të drejtë të themelojnë ndërmarrje, pa aprovimin paraprak të Qeverisë së Kosovës.
Ndërtimin e qendrës për mjekësi familjare.	Premtim i përmbushur.
Përcaktimin e zonës industriale.	Premtim pjesërisht i përmbushur. Zona është përcaktuar, por nuk ka pasur ndonjë projekt/nismë shtesë në këtë drejtim.
Ndërtimin e trafove të reja.	Premtim i përmbushur. Janë ndërtuar dy trafo njëra në lagjen "Gacaferri" dhe tjetra për Junik.
Ndërtimin e tregut të ri të gjelbër.	Premtim i pa përmbushur.

## 7. Burimet

1. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Raport vlerësimi. Nga pilot njësi komunale në komuna më të drejta të plota. Burimi: <http://www.osce.org/sq/kosovo/67466>
2. Agjencia e Statistikave të Kosovës. Rezultatet përfundimtare për Regjistrimin e Popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave - 2011. Komuna e Junikut. Burimi: [http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore\\_ALB.pdf](http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore_ALB.pdf)
3. Kuvendi i Kosovës. Ligji për Financat e Pushtetit Lokal. Burimi: [http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008\\_03-L049\\_al.pdf](http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L049_al.pdf)
4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Rezultatet përfundimtare për Kuvendet komunale nga zgjedhjet lokale të vitit 2009. Komuna e Junikut. Burimi: <http://www.kqz-ks.org/sq/rezultatet-2009/Index>
5. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2011 dhe 2010. Pjesa e dytë. Raporti Financiar i Komunës së Junikut . Burimi: [http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti\\_Junik\\_2011\\_ALB\\_402805.pdf](http://www.oag-rks.org/repository/docs/Raporti_Junik_2011_ALB_402805.pdf) & [http://www.oa-g-rks.org/repository/docs/Junik\\_alb\\_666846.pdf](http://www.oa-g-rks.org/repository/docs/Junik_alb_666846.pdf)
6. Instituti GAP. Si i shpenzon shteti paret tona. Komuna e Junikut. Mallra dhe shërbime. 2013. Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?junik/2013#/~junik/mallra-dhe-sherbime>
7. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Njoftimet e shpallura. 2010. Komuna e Junikut. Burimi: <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=28096>
8. Komuna e Junikut. Faqja zyrtare në internet. Burimi: <https://kk.rks-gov.net/junik/Home.aspx>
9. Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal. Raport: Vlerësimi i kapaciteteve të komunave në fushën e kompetencave vetanake dhe atyre të deleguara. Burimi: <http://www.mapl-ks.org/repository/docs/Mamushe.pdf>
10. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Statistikat e Arsimit në Kosovë 2011. Burimi: <http://www.masht-gov.net/advCms/documents/11052012.pdf>
11. Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Tabelat e Buxhetit të Kosovës për vitin 2011. Burimi: <http://mf.rks-gov.net/sq-al/ministriaefinancave/buxhetiirepublikesekosoves/buxhetikomunal.aspx>